

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** Shërbim i pastrimit të zonës bregdetare për bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Pogradec, e ndarë në lote si më poshtë:

Loti 1: Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Pogradec;

Loti 2: Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë dhe Sarandë

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):**

**90680000-7** Shërbime pastrimi të plazheve; **98341130-5** Shërbime pastrimi.

**VLERA E FONDIT LIMIT: 207,588,182.83** (dyqind e shtatë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy pikë tetëdhjetë e tre) **lekë, pa TVSH ose 2,168,022.79** (dy milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëzet e dy pikë shtatëdhjetë e nëntë) euro pa tvsh, e ndarë në lote si më poshtë:

**Loti 1: “Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Pogradec”** me fond limit 108,236,213.88 (njëqind e tetë milion e dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e trembëdhjetëpikë tetëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh ose 1,130,404.32 (një milion e njëqind e tridhjetë mijë e katërqind e katër pikë tridhjetë e dy) euro pa tvsh;

**Loti 2: “Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë dhe Sarandë”**, me fond limit 99,351,968.95 (nëntëdhjetë e nëntë milion e treqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë nëntëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh ose 1,037,618.47 (një milion e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë pikë dyzet e shtatë) euro pa tvsh;

*Referuar kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë datë 16.04.2026 (95.75 lekë/euro).*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

**LOTI 1: SHËRBIMI I PASTRIMIT TË ZONËS BREGDETARE PËR BASHKITË SHKODËR, LEZHË, DURRËS, KAVAJË, POGRADEC;**

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentim:** Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomikë kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë licence lëshuar nga QKB për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B, dhe duhet të disponojnë kodet si më poshtë:

- 20 01 08
- 20 02 01
- 20 03 04

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 41, pika 4, gërma a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke siguruar kështu AK që shërbimi do të kryhet nga operatorë të cilët disponojnë kapacitetet profesionale për kryerjen e këtij shërbimi, brenda standarteve.

Lloji dhe kategoria e licencës së kërkuar, duke përfshirë edhe kodet që duhet të disponojë kjo licencë, është vendosur nga eksperti i fushës, i kontraktuar nga AK përfitues. Ky kriter bazohet në Ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, nenin 68 Ligjin Nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, pasi licenca me (kodin III.2.B dhe kodet që duhet të disponojë (20 01 08, 20 02 01, 20 03 04) është në përputhje me zërat e realizimit të shërbimit dhe specifikimet teknike, ku kërkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane në venddepozitimet përkatëse.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë (të vlefshme), si më poshtë si më poshtë:

- SSH UNI DIN EN ISO 14001 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH UNI DIN EN ISO 9001 “Sisteme të menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH UNI DIN EN ISO 45001 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH UNI DIN EN ISO 39001 “Sistemet e Menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor” ose ekuivalente/të barazvlefshme.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, janë kërkuar këto certifikata me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë, mjedisit, të shëndetit dhe sigurisë në punë, si sisteme të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit.

Standarti ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm pasi garanton AK se operatori ka një sistem të menaxhimit të cilësisë të vendosur dhe funksional, duke siguruar zbatimin e procedurave të qarta për pastrimin e zonave bregdetare, në përputhje me rregulloret dhe ligjet mjedisore. Implementimi i këtij standarti ndihmon në reduktimin e kostove të panevojshme, rritjen e produktivitetit dhe optimizimin e burimeve dhe procesit të pastrimit, duke garantuar kështu realizimin e një shërbimi të qëndrueshëm dhe efikas për mbrojtjen e mjedisit.

Standarti 14001 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” – është vendosur si kriter duke marrë në konsideratë faktin që ky Standard është një sistem sistematik dhe i orientuar drejt procesit të menaxhimit të cilësisë për të kontrolluar impaktet e rëndësishme të aktiviteteve të biznesit në mjedis. Në rastin konkret, duke qenë se objekt i prokurimit është shërbimi i pastrimit të zonave bregdetare, paisja me këtë standart është e rëndësishme sepse siguron që ofertuesi ka sisteme të qarta për identifikimin dhe minimizimin e ndotjes gjatë pastrimit të zonave përkatëse, grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve sipas praktikave më të mira mjedisore, reduktimin e ndikimit negativ në ekosistemin bregdetar dhe biodiversitetin.

Standarti ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen shërbimin në përputhje me standartet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë. Pajisja e ofertuesve me këtë standart siguron që operatori gjatë realizimit të shërbimit objekt prokurimi, merr masa për parandalimin e aksidenteve gjatë punës, trajnime për punonjësit mbi përdorimin e siurt të pajisjeve/mjeteve dhe mbledhjen dhe transportimin e mbetjeve. Operatori ekonomik i pajisur me këtë standart krijon siguri për AK, se ka një sistem të strukturuar për identifikimin e rreziqeve që mund të ndodhin në vendin e punës, parandalimin e përhapjes së sëmundjeve te punonjësit për shkak të ekspozimit ndaj mbetjeve të rrezikshme, temperaturave të larta, e faktorë të tjerë që mund të ndikojnë gjatë realizimit të shërbimeve objekt prokurimi, dëmtimeve nga mjetet që do të përdoren për kryerjen e shërbimeve, etj. Gjithashtu, ofertuesit e pajisur me këtë standart garantojnë marrjen e masave për parandalimin e diskriminimit social dhe gjinor, shkeljeve të ligjit nga punonjësit, shfrytëzimit të punonjësve, punën e detyruar apo punësimin e të miturve.

Standarti ISO 39001 “Sistemet e Menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor” ose ekuivalente/të barazvlefshme vlerësohet i nevojshëm, duke marrë në konsideratë se kontraktuesi për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, duhet të kryejë edhe procesin e transportimit të mbetjeve në venddepozitimet përkatës, përmes itinerareve të përcaktuara në rrugë publike. Transporti i mbetjeve realizohet në rrugë publike, duke u shoqëruar me përdorimin e mjeteve teknologjike të rënda, duke krijuar rrezik real për sigurinë rrugore, nëse ky proces do të kryhet nga ofertues të cilët nuk zotërojnë sistemet e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor, vecanërisht në sezonin e verës. Disponimi i këtij Standarti synon të garantojë menaxhimin efektiv të sigurisë në trafik përmes planifikimit të sigurt të itinerareve, kontrollit të realizimit të këtij procesi, trajnimit të drejtuesve të mjeteve dhe monitorimit të vazhdueshëm të rreziqeve. Disponimi i këtij standarti i shërben gjithashtu mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të qytetarëve, si dhe realizimit të kontratës në përputhje me standartet më të mira të sigurisë.

Disponimi i standarteve të kërkuara në këtë kriter është vlerësuar nga eksperti i fushës, i kontraktuar nga AK përfitues, dhe është përcjellë pranë OBP.

2.3.4 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të pastrimit objekt prokurimi, duhet të kenë të punësuar minimumi 231 (dyqind e tridhjetë e një) punonjës, si më poshtë:

- 1 Drejtues Teknik/ Përgjegjës shërbimi
- 203 punonjës shërbimi
- 27 punonjës shofer

Për të përmbushur kriterin e mësipërm, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, për Drejtuesin Teknik/Përgjegjës shërbimi dhe punonjësit e shërbimit.

a. Për Drejtuesin Teknik/Përgjegjës të Shërbimit:

Drejtuesi Teknik/ Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë Inxhinier Mjedisi/Ekspert Mjedisi, dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

- Diplomë me profesion Inxhinier Mjedisi dhe/ose Certifikatë “Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor”;
- Kontratë pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;

b. Për punonjësit shofer

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)
- Leje Drejtimi për mjetet e kërkuara

c. Për punonjësit e shërbimit, të paraqitet:

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe specifikimeve teknike, hartuar nga AK.

Përgjegjësi i shërbimit nevojitet për organizimin, drejtimin, ndarjen dhe mbikëqyrjen e punëve, me qëllim që shërbimi objekt prokurimi të kryhet sipas specifikimeve teknike.

Duke vlerësuar që shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare, objekt prokurimi ka një ndikim të drejtëpërdrejtë në shëndetin e pushuesve, vlerësohet që përgjegjësi i shërbimit të jetë inxhinier mjedisi ose ekspert mjedisi, i cili do të kryejë mbikëqyrjen e realizimit të shërbimit, objekt prokurimi, konform kushteve dhe standarteve të kërkuara për mbrojtjen e mjedisit, si dhe në specifikimet teknike. Përgjegjësi i shërbimit me profil inxhinier mjedisi ose ekspert mjedisi siguron realizimin e shërbimit në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e mbetjeve, përdorimin e metodave të pastrimit në mënyrë të tillë që mbrojnë biodiversitetin, zgjedhjen e metodave më të përshtatshme të pastrimit, që nuk shkaktojnë ndotje shtesë.

Punonjësit e shërbimit janë të nevojshëm për të kryer të gjitha zërat e shërbimit, objekt prokurimi, si grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane, Pastrim i mbetjeve në plazhet publike, Mirembajtje e shetitoreve dhe pastrimi i koshave, Larje konteineresh. Punonjësit shoferë janë të nevojshëm për transportin e mbetjeve nga pikat e grumbullimit të tyre, deri në pikën fundore të depozitimit të tyre, të përcaktuar në specifikimet teknike.

Numri i punonjësve të shërbimit si dhe shoferëve është përcaktuar nga eksperti i fushës, (i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për llogaritje të cilit po kryhet prokurimi), i cili ka hartuar specifikimet teknike dhe numrin e punonjësve të shërbimit dhe shoferëve, bazuar në frekuencat përkatëse të secilit zë shërbimi, kohëzgjatjen e kontratës (93 ditë pune), në funksion të kërkesave të VKM nr. 319 datë 31.05.2018 „Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve“, sipas tabelës së vendosur në këtë procesverbal: Seksioni 2 ”Llogaritja e punonjësve”, Seksioni 3 ”Llogaritja e loteve”.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.5 Operatori ekonomik, duhet të disponojë 2 (dy) punonjës të certifikuar “Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”.

Për përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqitet dokumentacioni:

- Çertifikatë (të vlefshme) për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, lëshuar nga autoritetet/institucionet e autorizuar;
- Kontratë pune (e vlefshme).

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për këtë punonjës vendoset, bazuar në nenin 17 të ligjit 10237 datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, me qëllim që të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimit, këshillimit, pjesëmarrjes së balancuar, në përputhje me ligjin, formimit të punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre. Numri dy lidhet me volumin e punimeve që do të kryhen, proceset e punës, si dhe duke vlerësuar faktin e përfshirjes së disa bashkive, në një lot. Në një kontratë të tillë, aktiviteti zhvillohet paralelisht në territore të ndryshme, me ekipe pune, mjete dhe procese të shpërndara në disa zona, duke e bërë të vështirë mbulimin nga një person i vetëm përgjegjës për sigurinë në punë. Prania e dy specialistëve siguron mbulim efektiv dhe të vazhdueshëm në terren, mundëson ndjekjen dhe kontrollin e sigurisë në cdo zonë, si dhe reagim më të shpejtë në rast incidentesh apo rreziqesh, që mund të ndodhin gjatë realizimit të proceseve të shërbimit. Kërkesa për 2 punonjës vlerësohet proporcionale me përmasën dhe shpërndarjen e kontratës, duke synuar garantimin e sigurisë dhe shëndetit në punë, në të gjitha bashkitë ku do të kryhet shërbimi.

Disponimi i punonjësve në këtë kriter është vlerësuar nga eksperti i fushës, i kontraktuar nga AK përfitues, dhe është përcjellë pranë OBP.

2.3.6 Operatori ekonomik, duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:

- 5 (pesë) mjete teknologjike (kompatator) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, me ngarkim fundor ose anësor, me raport kompaktimi 1:4 – 1:6, dhe me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton.
- 8 (tetë) mjete teknologjike (kompatator) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, me ngarkim fundor ose anësor, me raport kompaktimi 1:4 – 1:6, dhe me kapacitet mbajtës 7-8 ton;
- 2 (dy) mjete teknologjike (kompatator) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, me ngarkim fundor ose anësor, me raport kompaktimi 1:4 – 1:6, dhe me kapacitet mbajtës 5-6 ton;
- 3 (tre) mjete teknologjike (kompatator) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, me ngarkim fundor ose anësor, me raport kompaktimi 1:4 – 1:6, dhe me kapacitet mbajtës deri në 1 ton;
- 3 (tre) Autobot Uji me kapacitet mbajtës jo më pak se 8000 Litra, i pajisur me pompë me presion për larje të ndryshme.
- 2 (dy) mjete teknologjike (skarrabel) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve urbane, inerte etj me ngarkim fundor ose anësor;
- 2 (dy) autobote uji i pajisur me pompe thithëse vakumi për thithjen e tualeteve portative të pozicionuara në plazhe dhe pompë lavazhi për pastrimin/dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre, me kapacitet mbajtës 2,000 – 3,000 litra;
- 1 (një) autobot uji i pajisur me pompë thithëse vakumi për thithjen e tualeteve portative të pozicionuara në plazhe dhe pompë lavazhi për pastrimin/dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre, me kapacitet mbajtës jo më shumë se 1,000 litra;

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet dokumentacioni i vlefshëm, si më poshtë:

- dokumentacion për mjetin në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

- Leja e qarkullimit të mjetit, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të mësipërme lidhet me proceset që duhet të kryejë ofertuesi për realizimin e shërbimit, objekt prokurimi, siç është: grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane, larja dhe desinfektimi i konteinerëve.

Numri i mjeteve është përcaktuar nga eksperti i fushës, (i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për llogari të së cilit po kryhet prokurimi), i cili ka hartuar specifikimet teknike dhe ka vendosur llojin dhe numrin e makinave/mjeteve, bazuar në nr. e konteinerëve, frekuencat dhe nr e turneve, të shërbimit të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane, larjes dhe desinfektimit të konteinerëve. Përzgjedhja e llojit të mjeteve dhe kapaciteti mbajtës i tyre është bërë nga eksperti i fushës, në funksion të infrastrukturës apo trafikut të secilës zonë, të llojit të konteinerëve të parashikuar për tu tërhequr në secilën zonë, si dhe bazuar në llogaritjet e kryera nga eksperti, sipas VKM nr. 319 datë 31.05.2018 „Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve“, duke argumentuar si vijon:

Mjetet teknologjike (kompaktor) përdoren për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve.

*Autobotët e ujit min. 8,000 L me pompë presioni përdoren për larjen dhe dezinfektimin e kontejnerëve, shpërlarjen e zonës përreth PGM-ve dhe ndërhyrje higjieno-sanitare ndihmëse.*

*Skarrabelët përdoren për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve të shpërndara, inerteve të lehta dhe mbetjeve voluminoze që nuk trajtohen me efikasitet nga kompaktorët.*

*Autobotët vakum/lavazh 2,000–3,000 L dhe autoboti vakum/lavazh deri 1,000 L përdoren për tualetet portative, për thithje, larje dhe dezinfektim, sipas kushteve të aksesit në terren.*

*Cisternat e ujit min. 25,000 L dhe autobotët e ujit me sprucim shërbejnë për furnizim ndihmës me ujë dhe për shpërlarje/pastrim të sipërfaqeve të forta dhe segmenteve rrugore të ndotura.*

*Autobotet me kapacitet 8000 litra dhe 25000 litra, ..., janë konsideruar si elementë mbështetës teknikë për garantimin e vijueshmërisë operative, rritjen e standardit higjieno sanitar dhe mbulimin efektiv të zonave të shërbimit, pa përbërë zëra të vecantë të koutuar në preventiv.*

2.3.7 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi) jo më pak se 20 tualete portative të përshtatshme për instalimin dhe stacionimin në zona bregdetare në përputhje me standartin SSH UNI DIN EN 16194 ose ekuivalent.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet dokumentacionin e vlefshëm, si skeda teknike të tualeteve dhe deklaratën e konformitetit sipas standartit të mësipërm ose ekuivalent.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Tualetet portative me standard SSH UNI DIN EN 16194 ose ekuivalent dhe numri i tyre është përcaktuar nga eksperti i fushës, i kontraktuar nga AK përfitues, i cili argumenton se ato përbëjnë element higjieno-sanitar ndihmës për zonat publike me fluks të lartë sezonal, dhe janë konsideruar si elementë mbështetës teknikë për garantimin e vijueshmërisë operative, rritjen e standardit higjieno-sanitar dhe mbulimin efektiv të zonave të shërbimit, pa përbërë zëra të vecantë të koutuar në preventiv.

Numri i kërkuar lidhet me shpërndarjen gjeografike të zonave të mbuluara. Standarti i kërkuar përcakton standartin që duhet të përmbushin Kabinat e tualeteve që nuk janë të lidhura me kanalizimet - Kërkesat e shërbimeve dhe produkteve në lidhje me vendosjen e kabinave dhe produkteve sanitare, duke garantuar kështu që këto tualete të jenë të përshtatshme për përdorim public.

2.3.8 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë, me anë të së cilës marrin përsipër të sigurojnë paisjen e punonjësve me mjete pune, sipas specifikimeve teknike, me shpenzimet e veta, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.

2.3.9 Operatët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë, me anë të së cilës marrin përsipër se shërbimi, objekt prokurimi do të kryhet nga Punonjës të pajisur me uniforma dalluese pune fosfoeshente, duke qenë se janë të ekspozuar ndaj lëvizjes së automjeteve apo aksidenteve të mundshme rrugore.

**Argumentimi për kriteret 2.3.8 dhe 2.3.9:** Këto kërkesa vendosen në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke iu referuar natyrës së objektit të prokurimit dhe specifikimeve teknike, dhe rrezikshmërinë që paraqet kryerja e të gjitha zërave të shërbimit objekt prokurimi në vetvete, është e rëndësishme për AK të krijojë siguri që ofertuesi do të kryejë këtë shërbim, në përputhje me specifikimet teknike, me cilësi dhe duke siguruar shëndetin dhe sigurinë teknike në punë të punëmarrësve të angazhuar.

Paraqitja e këtyre deklaratave është vlerësuar nga eksperti i fushës, i kontraktuar nga AK përfitues, dhe është përcjellë pranë OBP.

## **LOTI 2: SHËRBIMI I PASTRIMIT TË ZONËS BREGDETARE PËR BASHKITË RROGOZHINË, DIVJAKË, FIER, VLORË, HIMARË DHE SARANDË**

### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.2 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i

kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

### 2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentim:** Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

### 2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë licence lëshuar nga QKB për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B, dhe duhet të disponojnë kodet si më poshtë:

- 20 01 08
- 20 02 01
- 20 03 04

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 41, pika 4, gërma a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke siguruar kështu AK që shërbimi do të kryhet nga operatorë të cilët disponojnë kapacitetet profesionale për kryerjen e këtij shërbimi, brenda standarteve.

Lloji dhe kategoria e lejes së mjedisit të kërkuar, duke përfshirë edhe kodet që duhet të disponojë kjo licencë, është vendosur nga eksperti i fushës, i kontraktuar nga AK përfitues. Ky kriter bazohet në Ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, nenin 68 Ligjin Nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, pasi licenca me (kodin III.2.B dhe kodet që duhet të disponojë (20 01 08, 20 02 01, 20 03 04) është në përputhje me zërat e realizimit të shërbimit dhe specifikimet teknike, ku kërkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane në venddepozitimet përkatëse.

Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë (të vlefshme), si më poshtë si më poshtë:

- SSH UNI DIN EN ISO 14001 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH UNI DIN EN ISO 9001 “Sisteme të menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH UNI DIN EN ISO 45001 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH UNI DIN EN ISO 39001 “Sistemet e Menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor” ose ekuivalente/të barazvlefshme.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, janë kërkuar këto certifikata me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë, mjedisit, të shëndetit dhe sigurisë në punë, si sisteme të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit.

Standarti ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm pasi garanton AK se operatori ka një sistem të menaxhimit të cilësisë të vendosur dhe funksional, duke siguruar zbatimin e procedurave të qarta për pastrimin e zonave bregdetare, në përputhje me rregulloret dhe ligjet mjedisore. Implementimi i këtij standarti ndihmon në reduktimin e kostove të panevojshme, rritjen e produktivitetit dhe optimizimin e burimeve dhe procesit të pastrimit, duke garantuar kështu realizimin e një shërbimi të qëndrueshëm dhe efikas për mbrojtjen e mjedisit.

Standarti 14001 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” – është vendosur si kriter duke marrë në konsideratë faktin që ky Standart është një sistem sistematik dhe i orientuar drejt procesit të menaxhimit të cilësisë për të kontrolluar impaktet e rëndësishme të aktiviteteve të biznesit në mjedis. Në rastin konkret, duke qenë se objekt i prokurimit është shërbimi i pastrimit të zonave bregdetare, paisja me këtë standart është e rëndësishme sepse siguron që ofertuesi ka sisteme të qarta për identifikimin dhe minimizimin e ndotjes gjatë pastrimit të zonave përkatëse, grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve sipas praktikave më të mira mjedisore, reduktimin e ndikimit negativ në ekosistemin bregdetar dhe biodiversitetin.

Standarti ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen shërbimin në përputhje me standartet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë. Pajisja e ofertuesve me këtë standart siguron që operatori gjatë realizimit të shërbimit objekt prokurimi, merr masa për parandalimin e aksidenteve gjatë punës, trajnime për punonjësit mbi përdorimin e siurt të pajisjeve/mjeteve dhe mbledhjen dhe transportimin e mbetjeve. Operatori ekonomik i pajisur me këtë standart krijon siguri për AK, se ka një sistem të strukturuar për identifikimin e rreziqeve që mund të ndodhin në vendin e punës, parandalimin e përhapjes së sëmundjeve te punonjësit për shkak të ekspozimit ndaj mbetjeve të rrezikshme, temperaturave të larta, e faktorë të tjerë që mund të ndikojnë gjatë realizimit të shërbimeve objekt prokurimi, dëmtimeve nga mjetet që do të përdoren për kryerjen e shërbimeve, etj. Gjithashtu, ofertuesit e pajisur me këtë standart garantojnë marrjen e masave për parandalimin e diskriminimit social dhe gjinor, shkeljeve të ligjit nga punonjësit, shfrytëzimit të punonjësve, punën e detyruar apo punësimin e të miturve.

Standarti ISO 39001 “Sistemet e Menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor” ose ekuivalente/të barazvlefshme vlerësohet i nevojshëm, duke marrë në konsideratë se kontraktuesi për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, duhet të kryejë edhe procesin e transportimit të mbetjeve në venddepozitimet përkatës, përmes itinerareve të përcaktuara në rrugë publike. Transporti i mbetjeve realizohet në rrugë publike, duke u shoqëruar me përdorimin e mjeteve teknologjike të rënda, duke krijuar rrezik real për sigurinë rrugore, nëse ky proces do të kryhet nga ofertues të cilët nuk zotërojnë sistemet e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor, vecanërisht në sezonin e verës. Disponimi i këtij Standarti synon të garantojë menaxhimin efektiv të sigurisë në trafik përmes planifikimit të sigurt të itinerareve, kontrollit të realizimit të këtij procesi, trajnimit të drejtuesve të mjeteve dhe monitorimit të vazhdueshëm të rreziqeve. Disponimi i këtij standarti i shërben gjithashtu mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të qytetarëve, si dhe realizimit të kontratës në përputhje me standartet më të mira të sigurisë.

Disponimi i standarteve të kërkuara në këtë kriter është vlerësuar nga eksperti i fushës, i kontraktuar nga AK përfitues, dhe është përcjellë pranë OBP.

2.3.4 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të pastrimit objekt prokurimi, duhet të kenë të punësuar minimumi 191 (Njëqind e nëntëdhjetë e një) punonjës, si më poshtë:

- 1 Drejtues Teknik/ Përgjegjës shërbimi
- 21 punonjës shofer
- 169 punonjës shërbimi

Për të përmbushur kriterin e mësipërm, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, për Drejtuesin Teknik/Përgjegjës shërbimi dhe punonjësit e shërbimit.

a. Për Drejtuesin Teknik/Përgjegjës të Shërbimit:

Drejtuesi Teknik/Përgjegjës i shërbimit duhet të jetë Inxhinier Mjedisi/Ekspert Mjedisi, dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

- Diplomë me profesion Inxhinier Mjedisi dhe/ose Certifikatë “Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor”;
- Kontratë pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;

b. Për punonjësit shofer

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)
- Leje Drejtimi për mjetet e kërkuara

c. Për punonjësit e shërbimit, të paraqitet:

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.*

Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe specifikimeve teknike, hartuar nga AK.

Përgjegjësi i shërbimit nevojitet për organizimin, drejtimin, ndarjen dhe mbikëqyrjen e punëve, me qëllim që shërbimi objekt prokurimi të kryhet sipas specifikimeve teknike.

Duke vlerësuar që shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare, objekt prokurimi ka një ndikim të drejtëpërdrejtë në shëndetin e pushuesve, vlerësohet që përgjegjësi i shërbimit të jetë inxhinier mjedisi ose ekspert mjedisi, i cili do të kryejë mbikëqyrjen e realizimit të shërbimit, objekt prokurimi, konform kushteve dhe standarteve të kërkuara për mbrojtjen e mjedisit, si dhe në specifikimet teknike. Përgjegjësi i shërbimit me profil inxhinier mjedisi ose ekspert mjedisi siguron realizimin e shërbimit në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e mbetjeve, përdorimin e metodave të pastrimit në mënyrë të tillë që mbrojnë biodiversitetin, zgjedhjen e metodave më të përshtatshme të pastrimit, që nuk shkaktojnë ndotje shtesë.

Punonjësit e shërbimit janë të nevojshëm për të kryer të gjitha zërat e shërbimit, objekt prokurimi, si grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane, Pastrim i mbetjeve në plazhet publike, Mirembajtje e shetitoreve dhe pastrimi i koshave, Larje konteineresh. Punonjësit shoferë janë të nevojshëm për transportin e mbetjeve nga pikat e grumbullimit të tyre, deri në pikën fundore të depozitimit të tyre, të përcaktuar në specifikimet teknike.

Numri i punonjësve të shërbimit si dhe shoferëve është përcaktuar nga eksperti i fushës, (i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për llogari të së cilit po kryhet prokurimi), i cili ka hartuar specifikimet teknike dhe numrin e punonjësve të shërbimit dhe shoferëve, bazuar në frekuencat përkatëse të secilit zë shërbimi, kohëzgjatjen e kontratës (93 ditë pune), në funksion të kërkesave të VKM nr. 319 datë 31.05.2018 „Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve“, sipas tabelës së vendosur në këtë procesverbal: Seksioni 2 ”Llogaritja e punonjësve”, Seksioni 3 ”Llogaritja e loteve”.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.5 Operatori ekonomik, duhet të disponojë 2 (dy) punonjës të certifikuar “Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”.

Për përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqitet dokumentacioni:

- Çertifikatë (të vlefshme) për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, lëshuar nga autoritetet/institucionet e autorizuar;
- Kontratë pune (e vlefshme).

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për këtë punonjës vendoset, bazuar në nenin 17 të ligjit 10237 datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, me qëllim që të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimit, këshillimit, pjesëmarrjes së balancuar, në përputhje me ligjin, formimit të punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre. Numri dy lidhet me volumin e punimeve që do të kryhen, proceset e punës, si dhe duke vlerësuar faktin e përfshirjes së disa bashkive, në një lot. Në një kontratë të tillë, aktiviteti zhvillohet paralelisht në territore të ndryshme, me ekipe pune, mjete dhe procese të shpërndara në disa zona, duke e bërë të vështirë mbulimin nga një person i vetëm përgjegjës për sigurinë në punë. Prania e dy specialistëve siguron mbulim efektiv dhe të vazhdueshëm në terren, mundëson ndjekjen dhe kontrollin e sigurisë në cdo zonë, si dhe reagim më të shpejtë në rast incidentesh apo rreziqesh, që mund të ndodhin gjatë realizimit të proceseve të shërbimit. Kërkesa për 2 punonjës vlerësohet proporcionale me përmasën dhe shpërndarjen e kontratës, duke synuar garantimin e sigurisë dhe shëndetit në punë, në të gjitha bashkitë ku do të kryhet shërbimi.

Disponimi i punonjësve në këtë kriter është vlerësuar nga eksperti i fushës, i kontraktuar nga AK përfitues, dhe është përcjellë pranë OBP.

2.3.6 Operatori ekonomik, duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:

- 3 (tre) mjete teknologjike (kompatator) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, me ngarkim fundor ose anësor, me raport kompaktimi 1:4 – 1:6, dhe me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton;
- 3 (tre) mjete teknologjike (kompatator) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, me ngarkim fundor ose anësor, me raport kompaktimi 1:4 – 1:6, dhe me kapacitet mbajtës 8-10 ton;
- 2 (dy) mjete teknologjike (kompatator) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, me ngarkim fundor ose anësor, me raport kompaktimi 1:4 – 1:6, dhe me kapacitet mbajtës 6-7 ton;
- 2 (dy) mjete teknologjike (kompatator) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, me ngarkim fundor ose anësor, me raport kompaktimi 1:4 – 1:6, dhe me kapacitet mbajtës 3-5 ton;
- 2 (dy) cisterna Uji me kapacitet mbajtës jo më pak se 25,000 Litra.
- 2 (dy) autobote uji me kapacitet mbajtës jo më pak se 8,000 litra të pajisura me sistem sprucimi per pastrimin e rrugëve.
- 2 (dy) mjete teknologjike (skarrabel) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve urbane, inerte etj me ngarkim fundor ose anësor;
- 2 (dy) autobote uji i pajisur me pompe thithëse vakumi per thithjen e tualeteve portative te pozicionuara në plazhe dhe pompe lavazhi per pastrimin/dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre, me kapacitet mbajtës 2,000 – 3,000 litra;
- 1 (një) autobot uji i pajisur me pompe thithëse vakumi per thithjen e tualeteve portative te pozicionuara në plazhe dhe pompe lavazhi per pastrimin/dezinfektimin e tualeteve dhe vendqëndrimin e tyre, me kapacitet mbajtës jo më shumë se 1,000 litra;

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet dokumentacioni i vlefshëm, si më poshtë:

- dokumentacion për mjetin në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- Leja e qarkullimit të mjetit, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.*

Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të mësipërme lidhet me proceset që duhet të kryejë ofertuesi për realizimin e shërbimit, objekt prokurimi, siç është: grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane, larja dhe desinfektimi i konteinerëve.

Numri i mjeteve është përcaktuar nga eksperti i fushës, (i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për llogari të së cilit po kryhet prokurimi), i cili ka hartuar specifikimet teknike dhe ka vendosur numrin e makinave/mjeteve, bazuar në nr. e konteinerëve, frekuencat dhe nr e turneve, të shërbimit të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane, larjes dhe desinfektimit të konteinerëve. Përzgjedhja e llojit të mjeteve dhe kapaciteti mbajtës i tyre është bërë nga eksperti i fushës, në funksion të infrastrukturës apo trafikut të secilës zonë, të llojit të konteinerëve të parashikuar për tu tërhequr në secilën zonë, si dhe bazuar në llogaritjet e kryera nga eksperti, sipas VKM nr. 319 datë 31.05.2018 „Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve“, duke argumentuar si vijon:

Mjetet teknologjike (kompatator) përdoren për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve.

*Autobotët e ujit min. 8,000 L me pompë presioni përdoren për larjen dhe dezinfektimin e kontejnerëve, shpërlarjen e zonës përreth PGM-ve dhe ndërhyrje higjieno-sanitare ndihmëse.*

*Skarrabelët përdoren për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve të shpërndara, inerteve të lehta dhe mbetjeve voluminoze që nuk trajtohen me efikasitet nga kompaktorët.*

*Autobotët vakum/lavazh 2,000–3,000 L dhe autoboti vakum/lavazh deri 1,000 L përdoren për tualetet portative, për thithje, larje dhe dezinfektim, sipas kushteve të aksesit në terren.*

*Cisternat e ujit min. 25,000 L dhe autobotët e ujit me sprucim shërbejnë për furnizim ndihmës me ujë dhe për shpërlarje/pastrim të sipërfaqeve të forta dhe segmenteve rrugore të ndotura.*

*Autobotet me kapacitet 8000 litra dhe 25000 litra, ..., janë konsideruar si elementë mbështetës teknikë për garantimin e vijueshmërisë operative, rritjen e standardit higjieno sanitar dhe mbulimin efektiv të zonave të shërbimit, pa përbërë zëra të vecantë të koutuar në preventiv.*

2.3.7 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi) jo më pak se 20 tualete portative të përshtatshme për instalimin dhe stacionimin në zona bregdetare në përputhje me standartin SSH UNI DIN EN 16194 ose ekuivalent.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet dokumentacionin e vlefshëm, si skeda teknike të tualeteve dhe deklaratën e konformitetit sipas standartit të mësipërm ose ekuivalent.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Tualetet portative me standard SSH UNI DIN EN 16194 ose ekuivalent dhe numri i tyre është përcaktuar nga eksperti i fushës, i kontraktuar nga AK përfitues, i cili argumenton se ato përbëjnë element higjieno-sanitar ndihmës për zonat publike me fluks të lartë sezonal, dhe janë konsideruar si elementë mbështetës

teknikë për garantimin e vijueshmërisë operative, rritjen e standardit higjieno sanitar dhe mbulimin efektiv të zonave të shërbimit, pa përbërë zëra të vecantë të koutuar në preventiv.

Numri i kërkuar lidhet me shpërndarjen gjeografike të zonave të mbuluara. Standarti i kërkuar përcakton standartin që duhet të përmbushin Kabinat e tualeteve që nuk janë të lidhura me kanalizimet - Kërkesat e shërbimeve dhe produkteve në lidhje me vendosjen e kabinave dhe produkteve sanitare, duke garantuar kështu që këto tualete të jenë të përshtatshme për përdorim public.

2.3.8 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë, me anë të së cilës marrin përsipër të sigurojnë pajisjen e punonjësve me mjete pune, sipas specifikimeve teknike, me shpenzimet e veta, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.

2.3.9 Operatët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë, me anë të së cilës marrin përsipër se shërbimi, objekt prokurimi do të kryhet nga Punonjës të pajisur me uniforma dalluese pune fosforeshente, duke qenë se janë të ekspozuar ndaj lëvizjes së automjeteve apo aksidenteve të mundshme rrugore.

**Argumentimi për kriteret 2.3.8 dhe 2.3.9:** Këto kërkesa vendosen në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke iu referuar natyrës së objektit të prokurimit dhe specifikimeve teknike, dhe rrezikshmërinë që paraqet kryerja e të gjitha zërave të shërbimit objekt prokurimi në vetvete, është e rëndësishme për AK të krijojë siguri që ofertuesi do të kryejë këtë shërbim, në përputhje me specifikimet teknike, me cilësi dhe duke siguruar shëndetin dhe sigurinë teknike në punë të punëmarrësve të angazhuar.

Paraqitja e këtyre deklaratave është vlerësuar nga eksperti i fushës, i kontraktuar nga AK përfitues, dhe është përcjellë pranë OBP.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

***Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentat e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentat e kërkuar sipas legjislacionit të fushës.***

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike, numri i punonjësve, numri dhe kapaciteti teknik i mjeteve, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga eksperti, i kontraktuar nga autoriteti kontraktor “Agjencia Kombëtare e Bregdetit”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike, dhe të gjitha të dhënat për realizimin e proceseve të shërbimit objekt prokurimi, të hartuara nga specialisti i fushës janë pjesë e pandashme e DST. (Shtojca 6 e DST)

Në këto të dhëna, ndër të tjera eksperti sqaron:

### **Zëri 1: Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve Urbane.**

#### **Metodologjia dhe Specifikimet teknike**

*Ky shërbim konsiston në largimin e mbetjeve të depozituara në konteineret e depozitimit të mbetjeve nga subjektet/banorët/operatorët e pastrimit apo gjithkush tjetër që operon brenda zonës së pastrimit.*

#### **Volümet e punimeve dhe frekuenca e shërbimit**

*Autoriteti kontraktues për llogaritjen e kostos së grumbullimit dhe transportit të mbetjeve ka zbatuar modelin e llogaritjes së kësaj kostoje konform shtojcës 1 të zbatuar VKM Nr. 319, datë 31.5.2018 "Për Miratimin e Masave Për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.*

*Autoriteti kontraktor ka përcaktuar në kontratat me qeverisjet vendore të Shkodrës, Lezhës, Durrësit, Kavajës, Pogradecit, Rrogozhinës, Divjakës, Fierit, Vlorës, Himarës dhe Sarandës, numrin e konteinerëve, zonat ku do të vendosen si edhe frekuencën e terheqjes së tyre (2 herë në ditë, përgjatë fashës orare 18-00-06.00, gjatë 93 ditëve të sezonit turistik pra përgjatë periudhës 15 Qershor–15 Shtator 2026.).....*

### **Zëri 2- Mirëmbajtja e shetitoreve të plazheve dhe zbrastja e koshave 30, 20 , 10 litra**

***Ky shërbim konsiston në largimin e mbetjeve, pastrimin e koshave rrugorë në shetitoret pranë plazheve.***

*Autoriteti kontraktues ka parashikuar paraprakisht të gjitha zonat dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar. Keto zona janë shetitoret e plazheve, brenda zonës të përcaktuara në VKM nr 569, datë 17.07.2019, e ndryshuar...*

### **Zëri 3- Pastrimi i plazheve publike nga mbetjet**

#### **Volümet i punimeve**

*Autoriteti kontraktues ka parashikuar paraprakisht të gjitha zonat dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar. Keto zona janë shetitoret e plazheve, brenda zonës të përcaktuara në VKM nr 569, datë 17.07.2019, e ndryshuar. Operatori i shërbimit do të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha trotuarët e akseve kryesore të përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, për sipërfaqet e plazheve....*

### **Zëri 4-Larja dhe desinfektimi i konteinerëve.**

#### **Specifikime teknike dhe metodologjia**

*Shërbimi i larjes së dhe desinfektimit të konteinerëve konsiston në:*

*Larjen e konteinerëve me ujë dhe solucion universal lares, desinfektues dhe aromantizues dhe pa ndikim në mjedis, për të larguar të gjitha mbetjet e vogla që mund të qëndrojnë brenda konteinerit, larguar aromat e keqja, eliminimin e baktereve, si edhe përmirësimin e imazhit të zonës turistike. Po kështu ky shërbim do të shmangë grumbullimin e brejtësve, kafshëve të rrugës, vektorët (mushkonjë) e insekteve (grereza, miza etj) nga pikat e grumbullimit të mbetjeve, si edhe do të minimizojë rrezikun e përhapjes së baktereve në zonë në periudhën e nxehtë. Ky shërbim do të kryhet për konteinerët e kapacitetit mbajtës 1100 dhe 1700 litra*

Specialisti i fushës ka përcjellë gjithashtu numrin e punonjësve përkatës për secilin lot dhe proces shërbimi:

## SEKSIONI 2: LLOGARITJA E PUNONJËSVE

Bashkia	Loti	Ore plazh	Ore rrugë	Ore larje	Ore transport	Punonjës shërbimi	Shoferë	Total operativ
Shkodër	L1	24	28	5	183	30	4	34
Lezhë	L1	12	17	5	166	25	4	29
Pogradec	L1	8	11	5	96	15	2	17
Durrës	L1	200	17	2	421	80	9	89
Kavajë	L1	56	17	4	347	53	8	61
Vlorë	L2	356	28	4	84	59	7	66
Fier	L2	72	0	4	60	17	3	20
Himarë	L2	56	17	4	195	34	4	38
Sarandë	L2	32	11	4	153	25	3	28
Rrogozhinë	L2	56	0	4	76	17	2	19
Divjakë	L2	20	0	2	114	17	2	19

## SEKSIONI 3: PËRMBLEDHJE E LOTEVE

Loti	Punonjës	Shoferë	Total
Loti 1	203	27	231
Loti 2	169	21	191

Në dokumentacionin e përcjellë pranë OBP, specialisti i fushës përcakton si dokument shoqërues të specifikimeve teknike:

*Dokumenti shoqërues i Specifikimeve Teknike 2026*

### 1. Parime të zbatimit

- Hartat e Aneksit 1 përdoren për përcaktimin territorial të zonave bregdetare ku do të kryhet shërbimi.
- Planet e pastrimit të Aneksit 2 përdoren për emërtimin e nënzoneve dhe shpërndarjen operative të kontejnerëve/koshave.
- Kur Aneksi 2 përfshin koshat e vegjël publike (30 L, 20 L, 12 L, 10 L), këto llogariten si elementë të shërbimeve mbështetëse dhe nuk sjellin ndryshim të fondit total apo të loteve.
- Kur një marrëveshje ka qeliza bosh ose jo plotësisht të shkruara në planin e pastrimit, për qëllime të kostimit dhe kualifikimit mbeten në fuqi totalitet miratuara në specifikimet dhe modelet e kostos.
- Për Zërin 'Larje kontejnerësh' frekuenca operative mbetet 1 herë në muaj, sipas versionit të rishikuar të dokumentit.

### 2. Rakordimi teknik sipas bashkive - Loti 1

- Shkodër: Aneksi 2 konfirmon Velipojë (300 x 1100 L) dhe Baks-Rrjoll (100 x 1100 L); tabela e detajuar lexohet sipas marrëveshjes.
- Lezhë: Aneksi 2 liston Rrjollë, Rana e Hedhun, Shëngjin dhe Tale; për qelizat bosh të Rrjollës dhe Ranës ruhen totalitet agregate dhe modeli financiar i miratuar.
- Durrës: marrëveshja jep ndarje operative me 1100 L, 240 L dhe 30 L për Gjiri i Lalzit, Currila-Kallm, Currila dhe Plazhi i Madh; kjo ndarje merret për planin në terren pa ndryshuar vlerën e Lotit 1.

• *Kavajë: Aneksi 2 konfirmon Golem-Qerret 220 x 1700 L + 30 x 240 L dhe Karpen 30 x 1700 L; kjo nëndarje prevalon ndaj çdo përshkrimi të mëparshëm të detajuar që bie ndesh me të.*

• *Pogradec: Aneksi 2 konfirmon Lin 10, Piskupat 5, Udenisht 10, Memelisht 10, Pogradec-Tushemisht 100, si dhe Pogradec urban 12 L = 150 dhe 10 L = 30; nëndarja operative pranohet pa ndryshuar totalin e Lotit 1.*

### *3. Rakordimi teknik sipas bashkive - Loti 2*

• *Rrogozhinë: Aneksi 2 konfirmon Spille dhe plani operacional përkatës.*

• *Divjakë: Aneksi 2 i marrëveshjes është korriguar me amendim; në çdo rast prevalon akti amendues i datës 13.01.2026.*

• *Fier: Aneksi 2 konfirmon Seman 1 = 21 x 1100 L, Seman 2 = 4 x 1100 L dhe Darëzezë-Pishë Poro = 37 x 1100 L; pa 240 L të shënuara në marrëveshje.*

• *Vlorë: Aneksi 1 dhe Aneksi 2 konfirmojnë 6 nënzona operative; tabelat lexohen sipas ndarjes operative të marrëveshjes.*

• *Himarë: marrëveshja konfirmon 10 nënzona të pastrimit dhe planin përkatës të kontejnerëve.*

• *Sarandë: Aneksi 1 jep 3 zona të hartuara, ndërsa Aneksi 2 i ndan operacionet në 4 nënzona (Pllakat, Qytet, Ksamil, Ksamil 1); të dy anekset lexohen së bashku.*

### *4. Dispozitë përfundimtare e rakordimit*

*Në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit, emërtimet e zonave, nënzonave dhe planit të pastrimit konsiderohen të rakorduara sipas anekseve bashkëlidhur. Për çdo pikë ku dokumentet operative të bashkive japin ndarje më të imtësishme se tabela e përgjithshme e procedurës, ndarja operative merret për organizimin e shërbimit, ndërsa referencat financiare dhe totalët e loteve mbeten të pandryshuara.*

*Në dokumentacionin e përcjellë pranë OBP nga AK përfitues, është argumentuar ndarja në 2 lote si vijon:*

*Ndarja në 2 ( dy) lote është bërë mbi bazë gjeografike duke grupuar bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë dhe Pogradec në një lot me vazhdimësi territoriale dhe intensitet të lartë turistik, ndërsa bashkitë Vlorë, Himarë, Rrogozhinë, Sarandë, Divjakë dhe Fier janë përfshirë në një lot të dytë, për të optimizuar logjistikën dhe për të garantuar një shërbim të qëndrueshëm gjatë sezonit veror.*

*Ndarja në më shumë lote është shmangur pasi do të ulte ekonominë e shkallës dhe do të rriste kostot, ndërkohë që koordinimi në një periudhë kaq të shkurtër mes shumë operatorëve do të ishte i vështirë dhe do të rrezikonte cilësinë e shërbimit, si dhe do të shtonte mundësinë e dështimit të operatorëve më të vegjël për të përballuar kërkesën e lartë, duke cenuar imazhin e turizmit në momentet e pikut të fluksit.*